

KOMPNIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UHLANJANJE OTRAGA

"ÇABRATI" SH.A-JSC:DD.

Nr.No.Br. 439 Shtese 1

Dt: 23.02.2023

Qershor 2023

Raport Vjetor (2022)

Kompania Rajonale të Mbeturinave "Çabрати" Sh.A

KRM "Çabрати" Sh.A

Kushtet e Referencës

Ky raport pasqyron gjendjen reale të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave KRM "Çabрати" SH.A., ku nga Bordi i Drejtorëve i zgjedhur nga Komisioni i Aksionarëve me datë 22 Janar 2020, në takimin konstituiv, morri detyrën për të vazhduar punën dhe aktivitetet vendimarrëse të kompanisë në fjalë.

Qëllimi në përmbajtje të raportit është informimi i Komisioni të Aksionarëve të KRM "Çabрати" SH. A në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2022.

Bordi i Drejtorëve të KRM "Çabрати" SH.A., ka pasqyruar në këtë raport të gjitha aktivitetet e ndodhura gjatë vitit 2022, të cilat janë ndërmarrë në periudhë raportuese Janar – Dhjetor 2022, ku të gjithë zyrtarët e lartë kanë pasqyruar raportin e kërkuar për këtë periudhë raportuese.

Përmbledhja e Raportit

Raporti përmbanë aktivitetet ekonomike, financiare dhe juridike të kompanisë në fjalë, të cilat tashmë kanë ndodhur gjatë vitit 2022.

Periudha raportuese (01 Janar deri me 31 Dhjetor 2022) e paraqitur si në vijim:

- Zyrja e Kryeshefit Ekzekutiv (kontratat dhe vendimet e nxjerrura gjatë kësaj periudhe, projektet e realizuara, të planifikuara dhe ato të cilat janë në process e sipër);
- Zyrja Ligjore (Kronologjia e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve, vendimet e nxjerrura si dhe mbledhjet nga Komiteti i Auditimit të brendshëm);
- Zyrja e Thesarit dhe Financave (Gjendja financiare e Kompanisë e pasqyruar gjatë 12 muajve operues).
- Zyrja e Prokurimit (Kontratat e nënshkruara gjatë kësaj periudhe raportuese);
- Zyrja e Burimeve Njerzore (Pasqyrimi i numrit të punëtorëve të pranuar, larguar, pensionuar gjatë vitit 2022, si dhe struktura gjinore e punëtorëve në Kompani);
- Operativa (Shpenzimet e ndodhura, realizimi i planit operues, mjetet motorike në dispozicion).

Përmbledhja e veprimtarisë së Kompanisë

Kompania ushtron veprimtarin e saj sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës (Ligji Nr. 06/L-016) Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087), Ligjit për Mbeturina (Ligji Nr. 04/L-060) i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2012) dhe Statutit të KRM "Çabрати" SH.A. Gjakovë.

Mbikëqyrja e KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë, bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe Bordi Drejtorëve, kurse udhëheqja e kompanisë bëhet nga Stafi Menaxhues (Zyrtarët e lartë dhe zyrtarët tjerë). Veprimtaria e kompanisë ushtrohet kryesisht me mjete vetanake si për veprimtari primare dhe ajo sekondare kryesisht me kontrata apo marrëveshje me Komunën e Gjakovës.

Selia e Ndërmarrjes është e ndarë në dy njësi: njësia qendrore - Drejtoria me seli në rrugën "Mazllom Lakuci" dhe njësia teknike (Operativa) e cila ndodhet në objektin e "Ish SPM-Policia e Vjetër" Rr. Nëna Terezë. Përpos selisë qendrore dhe operative, kemi në shfrytëzim me të drejtë shfrytëzimi edhe objektin e "Varrezave të Qytetit" në lagjen "Brekoc" dhe objektin "Stacioni transferues i mbeturinave" në lagjen "Ali Ibra" me afat shfrytëzimi 5 /pesë/ vjeçar. Krahas Stacionit Transfer përgjatë vitit 2021 është përfunduar edhe Oborri Riciklues i cili është fituar grandit me BE IPA II kross Boorder Kosovë-Mali i Zi. Gjithashtu kompania përgjatë vitit 2022 ka në shfrytëzim lokacionin tek Qerdhja "Ganimete Terbeshi" pikë e shitjes në shfrytëzim për 2 vite dhe Tregun e Gjellbërt që gjendet në rrugën "Yll Morina" në marrëveshje me Komunën e Gjakovës.

Kompania ofron tri lloje të shërbimeve të bartjes së mbeturinave: konsumatorët e ekonomive familjare, (amvisëritë), bizneset e vogla, të mesme dhe ato të mëdha, si dhe institucionet (Shkollat, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Qendrat e mjekësisë së Përgjithshme-Spitalet Rajonale, Qendrat Kulturore e Sportive, Muzetë, Entet, Ndërmarrjet Publike etj.

Konsumatorët e amvisërive ndahen në dy kategori, në ato që e pranojnë shërbimin "derë më derë" dhe ata të cilët shërbejnë apo janë të pajisur me kontejnerë.

Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin në vijueshmëri me apo pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit.

Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve, që zakonisht janë të shërbyera me kontrata të veçanta me kontejnerë të veçantë të vëllimit 1.1m.

Aktiviteti operative primarë:

Ofrimi i Shërbimeve të Grumbullimit dhe Transporti i Mbeturinave Komunale në tërë territorin e Komunës së Gjakovës.

Aktivitetet sekondare, të cilat bazohen në kontrata të veçanta, kryesisht me komunën:

- Menaxhimi i Stacionit Transferimit të mbeturinave;
- Menaxhimi i Tregut të Gjëlbert në lagjen Orize Blloku i Ri;
- Menaxhimi i varrezave të qytetit;

Menaxhimi i shërbimit të varrimeve paraqitet si aktivitet sekondar për nga rëndësia e të hyrave në ndërmarrje. Gjatë kësaj periudhe raportuese, personeli i rregullt i angazhuar rreth varrezave të qytetit me numër ka qenë: 6 punëtor, prej tyre 1/një/ përgjegjës, 1/një/ rojtar dhe 4 /katër/ punëtorë-varrtarë të angazhuar në baza ditore, plus kemi angazhuar edhe punëtor shtesë, kur ka pasur më shumë se tre raste të varrimeve për një ditë. Ofrimi i shërbimit të varrimeve janë të koordinuar me operativën dhe zyrën për faturim/ inkasim. Duke filluar nga 01.01.2022 e deri me 31.12.2022, kemi pasur:

1. Varrime me transport 85 copë
2. Varrime pa transport 217 copë
3. Varrime e porsalindurve 7 copë
4. Rezervime/vazhdime të kontratave 106 copë
 - Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike dhe pastrimi i rrugëve;

KRM "ÇABRATI" SH.A. Gjakovë, ka pasur dy marrëveshje me Komunën e Gjakovës për kryerje të punëve sekondare,

1. Marrëveshja "Për Mirëmbajtjen dhe Pastrimin e Rrugëve Publike;
2. Marrëveshje "Për Mirëmbajtja e Gjëlberimit dhe Mbjellja e Fidanëve, Drunjëve Dekorativë dhe Luleve".

Ndërsa gjatë viti 2021 kemi nënshkruar memorandumin me Komunën dhe atë:

1. Memorandum për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale.

Në vitin 2022 të dy kontratat dhe marrëveshjen e kemi fuzionuar me një Marrëveshje gjithëpërfshirëse:

1. "Mirëmbajtja e Autorrugëve dhe Mirëmbajtja e Gjëlberimit".

Kjo kontratë ka afat 1 /një/ vjeçare, dhe sipas kësaj kontrate kryhen të gjitha shërbimet.

Mirëmbajtja e hapësirave në Spitalin Rajonal Isa Grezda, Institutin e Mjekësisë Punës, Qendrën e Mjekësisë Familjare dhe në të gjitha QMF-të.

Aktivitetet e saj, kompania i realizon përmes departamenteve operative dhe shërbimit për konsumatorë, dhe sektorëve tjerë mbështetës financiar dhe juridiko-administrativ, të cilat përbëjnë tërësinë e ndërmarrjes.

I. Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

K.E. Behar Ferizi

Kontratat e nënshkruara 2022 dhe llojet e tyre

Gjatë vitit 2022 janë nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv 6 kontrata si dhe janë lidhur 8 marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi të cilat janë si në vijim:

1. Marrëveshje mirëkuptimi në mes të Autoshtollës Blendi dhe KRM Çabratit;
2. Marrëveshje për kryerjen e shërbimeve/pagesave ndërmjet N.SH. Vllesha-CO SH.P.K dhe KRM Çabratit;
3. Kontratë për kryerjen e shërbimeve postare ndërmjet Posta e Kosovës SH.A. dhe KRM Çabratit;
4. Marrëveshje bashkëpunimi për dhënie në shfytëzim të përkohshëm të mjetit të punës bagerit (ULTA) ndërmjet Ngrohtorjes së Qytetit SH.A. dhe KRM Çabratit Sh.A;
5. Marrëveshje për mirëmbajtjen e gjelbrimit dhe mbjellja e fidaneve, drunjëve dekorativ dhe luleve ndërmjet Komuna e Gjakovës dhe KRM Çabratit;
6. Marrëveshje ndërmjet Komuna Gjakovë dhe KRM Çabratit për dhurimin e dy kamionëve për të cilët komuna ka qenë përfituese në kuader të Grandit të Përformances;
7. Kontratë - Mirëmbajtja e oborrit të spitalit ndërmjet Spitalit të përgjithshëm "Isa Grezda" dhe KRM Çabratit;
8. Kontratë për kryerjen e shërbimeve/mbledhja e biomases ndërmjet KRM Çabratit dhe Ngrohtorja e Qytetit Sh.A.
9. Kontratë për dhënie në shfytëzim afatshkurtër të pronës Komunale Tregut Orizë ndërmjet Komunes Gjakovës dhe KRM Çabratit;
10. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Gazeta GjakovaPress dhe KRM Çabratit;
11. Kontratë për kryerje të shërbimeve/pastrimi, grumbullimi dhe bartja e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura dhe dërgimi i tyre në Landovicë, ndërmjet KRM Çabratit dhe KRU Gjakovë SH.A;
12. Marrëveshje për sponsorizim ndërmjet Klubit Basketbollit "Vllaznimi" dhe KRM Çabratit;
13. Kontratë Shërbimi/dërgimi i mbeturinave në Landovicë ndërmjet KRM Çabratit SH.A. dhe KMDK-së;

14. Marrëveshje për Mirembajtjen e gjelbrimit, mbjelljen e fidaneve, drunjeve dekorative, luleve, si dhe për mirembajtjen e Auto-Rrugëve në mes të Komunë së Gjakovës dhe KRM Çabrat Sh.A.

Nr. i vendimeve të nxjerrura

➤ Numri i vendimeve të nxjerrura ne vitin 2022:

Numri vendimeve të nxjerrura nga Kryeshefi Ekzekutiv për vitin 2022 ka qenë nga 01 deri 199.

Numri i raporteve të prezantuara në mbledhje të Bordit dhe të aprovuara

Me kërkesën e Bordit të Drejtorëve sipas rendit të ditës dhe mbledhjeve të rregullta nga Kryeshefi Ekzekutiv janë raportuar **nëntë (9)** raporte në mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtoreve, si dhe të gjitha janë të aprovuara.

Po ashtu është mbajtur edhe mbledhja me Komisionin Komunal të Aksionarëve në muajin Qershor 2022 si dhe është aprovuar raporti vjetor i KE.

Të arriturat (rezultatet) e realizuara gjatë vitit 2022

Rezultatet e arrituara gjatë implementimit të projekteve dhe iniciativave të ndryshme gjatë vitit 2022:

- Ndarja në burim i mbeturinave të riciklueshme, grumbullimi dhe presimi i tyre në oborrin riciklues (e vetmja kompani lokale publike në Kosove e cila bën riciklimin e mbeturinave);
- Pastrimi në tërësi i sipërfaqes në lagjen Ali Ibra, në pjesën para Stacionit Transfer të mbeturinave (mbeturina të grumbulluara nga viti 2014);
- Shërbim në të gjitha fshatrat e Komunës së Gjakovës dhe lidhja e kontratave të reja me klientët e ri;
 - Amvisëri **706** konsumatorë të rinj;
 - Jo rezident **1,917** konsumatorë të rinj;
 - Biznes i vogël **178** konsumator të rinj;
 - Biznes i madh **48** konsumator të rinj;
 - Institucione **3** konsumator të rinj;

Totali për vitin 2022, **2,804** konsumator të rinj.

- Rritja e Faturim-Inkasimit;

Rritja e % së faturimit në vitin 2022 krahasuar me 2021 **(6.97%)**;

Rritja e % së inkasimit në vitin 2022 krahasuar me 2021 **(29.07%)**;

Rritja e vlerës së faturimit në vitin 2022 krahasuar me 2021 **(103,081.45 Euro)**;

Rritja e vlerës së inkasimit në vitin 2022 krahasuar me 2021 **(379,440.46 Euro)**;

- Inkasimi i borgjeve të vjetra të akumuluar ndërvite nga klientët;
- Tërheqja e deponive ilegale;
- Hapja e pikës së re të inkasimit në lagjen Orize në Blllokun e Ri;
- Menagjimi i Tregut të gjelbërt në Lagjen Orize në Bllloku i Ri;
- Renovimi i kontratave për klientët;
- Renovimi i flotes të makinerive në sektorin e Operatives;
- Renovimi total i objektit Administrates si dhe pjesërisht objektit në Operativë;

II. Sektori Juridik

Kronologjia e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve:

Bordi i Drejtorëve i KRM “Çabrati” Sh.A. Gjakovë, ka mbajtur takime të rregullta në baza mujore dhe takime të jashtëzakonshme sipas nevojës, ku në secilën mbledhje janë trajtuar pikat e zakonshme si kuorumi, aprovimi i pikave të rendit të ditës dhe i procesverbalit paraprak, shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Komisionit të Auditimit dhe raportit të Kryeshefit Ekzekutiv.

Gjatë vitit 2022, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsej 12 takime, (të rregullta dhe të jashtëzakonshme) përfshirë edhe takimin vjetor me Komisionin Komunal të Aksionarëve.

Bordi i Drejtorëve i KRM “Çabrati” Sh.A, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, si dhe Statutin e Kompanisë, ka shqyrtuar çështjet afariste të Ndërmarrjes dhe ka aprovuar projekte, plane, raporte dhe kërkesa të parashtruara gjatë takimeve.

Më poshtë është paraqitur kronologjia me miratimet dhe amprovimet; vendimet që janë marrë nga takimet e Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm të KRM “Çabrati” Sh.A. Gjakovë.

Vendimet (8) ; Miratimet (16) ; Autorizimet (0)

BORDI I DREJTORËVE / TAKIMI I DT. 18.02.2022

1. MIRATOHET: Raporti përmbledhës i BD i aktiviteteve për vitin 2021.
2. MIRATOHET: Raporti vjetor i KE për periudhën janar-dhjetor 2021.
3. VENDIM: Miratohet kërkesa e Kryeshefit Ekzekutiv, që të bëhet rritja e poenit në pagën bazë në vlerë prej 40 (dyzet) poena, për të gjitha kategoritë e punëtorëve të Ndërmarrjes Publike KRM "Çabrat" Sh.A., Gjakovë.

1. BORDI I DREJTORËVE / TAKIMI I DT. 15.04.2022

2. MIRATOHET Raporti i Kryesuesit të Komitetit të Auditimit për periudhën janar, shkurt dhe mars 2022.
3. MIRATOHET Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për periudhën shkurt dhe mars 2022.

BORDI I DREJTORËVE / TAKIMI I JASHTËZAKONSHËM DT. 15.05.2022

Shqyrtimi i kërkesës me numër protokoli 728/10, i datës 28.04.2022, të parashtruar nga z. Jeton Sokoli, Pastor i Kishës Rilindja e Kosovës.

PËLQIM PARIMOR: Miratohet kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale, sipas kërkesës me numër protokoli 728/10, të datës 28.04.2022, e parashtruar nga Z. Jeton Sokoli, Pastor i Kishës Rilindja e Kosovës.

1. Obligohet Sekretari i Kompanisë që të procedojë më tutje kërkesën në fjalë sipas procedurave ligjore në fuqi.
2. Me dhënien e këtij Pëlqimi Parimor, Bordi i Drejtorëve konsideron se nuk është kompetent për vendimmarrje të procedurave të më tutjeshme.

BORDI I DREJTORËVE / TAKIMI I JASHTËZAKONSHËM DT. 27.05.2022

Situata në Stacionin Transfer;

V E N D I M:

1. Ndalohet rreptësishtë zbraza e mbeturinave jashtë vendit të destinuar, sipas vendimit nr.463/02-13906, të datës 27.05.2021, lëshuar nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – Stacionin Transfer me numër
2. të parcelës P-70705028-05747-1;
3. Hedhja e mbeturinave nga KRM "Çabрати" Sh.A. jashtë lokacionit të destinuar, është e papranueshme dhe gjithashtu e dënueshme, dhe nëse ndodhë një gjë e tillë do të merren masa ndaj menaxhmentit dhe personave përgjegjës që udhëheqin me Kompaninë.
4. 3. Obligohet Menaxhmenti i Kompanisë që të ndërmerr masa të menjëhershme për: ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë destinacionit të ndarë sipas vendimit të cekur më lartë; si dhe menjëherë të fillojë largimin e mbeturinave të krijuara jashtë lokacionit në fjalë.

MBLEDHJA VIETORE E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE DHE BORDIT TË DREJTORËVE DT

24.06.2022

Miratime/ Vendime:

MIRATOHET Raporti vjetor 2021 i prezantuar nga kryesuesja e Bordit të Drejtorëve, KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.

MIRATOHET Raporti i Auditorit të Jashtëm, për Pasqyrat Financiare për vitin 2021 të KRM Çabрати Sh.A.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I JASHTËZAKONSHËM NR I DT. 27.06.2022

1. Shqyrtimi i kontratës së punës për pozitën e Këshilltarit të Përgjithshëm/ Sekretarit Korporativ.

Bordi i Drejtorëve lidhur me këtë pikë, pas shqyrtimit dhe diskutimit të saj, me votim unanim morën:

V E N D I M:

Besnik Avdiu, me pozitë pune Këshilltar i Përgjithshëm /Sekretar Korporativ në KRM "ÇABRATI" Sh.A., të cilit i skadon kontrata e punës me datë 30.06.2022, të njëjtit i vazhdohet kontrata e punës si Ushtrues i Detyrës në pozitën e njëjtë, deri sa të kryhet rekrutimi i rregullt sipas konkursit publik për këtë pozitë.

V E N D I M

Të shpallet konkursi për pozitën e Këshilltarit të Përgjithshëm /Sekretarit Korporativ të KRM Çabрати Sh.A., Gjakovë.

Konkursi të shpallet me datë 01.07.2022, në kohëzgjatje prej 30 ditësh kalendarike, në të dy gjuhët zyrtare (Shqip; Serbisht), në njërën nga gazetatat ditore, në uebfaqen e Ndërmarrjes dhe të Komunës së Gjakovës.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I DT. 02.08.2022

Miratime/ Vendime:

MIRATOHET Raporti i Kryesuesit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm i pasqyrave financiare për muajin: prill, maj, qershor 2022.

MIRATOHET Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, për periudhën prill, maj, qershor 2022. Nga Sekretari i Kompanisë kërkohet që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, të publikohet konkursi sipas dispozitave ligjore në fuqi, duke u bazuar në dispozitivin e këtij vendimi.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I JASHTËZAKONSHËM DT. 04.08.2022

Hapja e aplikacioneve të kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën Këshilltar i përgjithshëm/ Sekretar Korporativ në KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë, sipas konkursit të shpallur me datë 30.06.2022.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I DT. 29.08.2022

Miratime/ Vendime:

MIRATOHET Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, për muajin korrik 2022.

VENDIM:

1. Të vazhdohet me procedurat e përmbarimit, për të gjithë konsumatorët të cilët kanë obligime në shumën mbi 50 (pesëdhjetë) Euro, ndaj Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.
2. Perludha e kërkesës së obligimeve (borxheve) të konsumatorit të jetë duke filluar nga 01.01.2013 deri në faturimin e fundit, sipas kartelës së konsumatorit i cili ka borxhe të pa paguara ndaj Kompanisë.
3. Obligohet Menaxhmenti i Kompanisë për ekzekutimin e këtij vendimi.

☑ VENDIM:

1. Besnik Avdiu, emërohet Këshilltar i Përgjithshëm/ Sekretar Korporativ në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Çabрати" Sh.A, Gjakovë, me mandat tre (3) vjeçar, duke filluar nga data 01.09.2022 deri me datë 31.08.2025.

2. I punësuar, detyrat e punës do t’i kryej në bazë të rregullores së brendshme për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Përgjegjësitë, sipas Statutit të Kompanisë, ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nën ligjore.

3. Kompensimi i pagës do të bëhet në baza mujore sipas nivelit të caktuar me Rregullore të Brendshme të Ndërmarrjes, për përcaktimin e poenëve për këtë pozitë.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I DT. 11.10.2022

Miratime/ Vendime:

MIRATOHET Raporti i Kryesuesit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm i pasqyrave financiar për muajin korrik dhe gusht 2022.

MIRATOHET Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, për muajin gusht dhe shtator 2022.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I DT. 17.11.2022

Miratime/ Vendime:

MIRATOHET Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, për muajin tetor 2022.

MIRATOHET Biznes Plani i vitit 2023, i KRM “Çabрати” Sh.A. Gjakovë.

BORDI I DREJTORËVE /TAKIMI I DT. 29.12.2022

Miratime/ Vendime:

MIRATOHET Raporti i Kryesuesit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm i pasqyrave financiar për muajin shtator, tetor dhe nëntor 2022.

MIRATOHET Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, për muajin nëntor 2022.

MBLEDHJET E KOMISIONIOT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Spektori Juridik - Sekretari

Gjatë vitit 2022 nga Spektori Juridik janë përpiluar:

- 12 procesverbale të mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve.
- 5 procesverbale nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit të Brendshëm.
- 8 Vendime të Bordit të Drejtorëve;

- 66 Vendime të Kryeshefit Ekzekutiv.
- Shqyrtimi dhe hartimi i kontratave dhe marrëveshjeve të ndryshme.
- Kërkesa dhe angazhimi për pajisje me Leje Mjedsore i Kompanisë për Stacionin Transfer.
- Shqyrtimi i prapësimeve përmbartimore dhe përpilimi i parashtresave në procedurat përmbartimore, caktime të përfaqësuesve përmbartimor, precizime, përfaqësime etj.
- Pranimi i Aktvendimeve/Aktgjykimeve për rastet gjyqësore, shqyrtimi i tyre dhe përpilimi i parashtresave sipas afateve ligjore.
- Vërtetime/ Pëlqime ku gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar tetë (8) kërkesa për ndërtime të objekteve banimore. Njëri ndër kushtet kryesore që Kompania ka kërkuar të përmbushet para lëshimit të vërtetimit është shlyerja e borxhit në tërësi ndaj kompanisë.
- Si pjesë përbërëse e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, kemi dhënë përgjigje në ankesat e parashtruara nga konsumatorët në lidhje me borxhet që kanë ndaj kompanisë Shqyrtimi dhe përgatitja e parashtresave për rastet gjyqësore, si dhe përfaqësimi i Kompanisë pranë Gjykatave vendore.
- Angazhim në këshilla juridike dhe ligjore, të paraqitura sipas nevojës për të gjitha Sektorët dhe nga punëtorët e Kompanisë.
- Takime me palë të ndryshme, për çështje të dërgimit të përmbartuesi privat, për shkak të borxheve të papaguara ndaj Kompanisë dhe çështje tjera.
- Përpilimi i shkresave të ndryshme, njoftimeve, autorizimeve etj.
- Punë të tjera organizative dhe administrative.

Përmbledhje rreth rasteve gjyqësore aktive dhe të përfunduara

1. Rasti i parë: rasti C.nr. 1251/19 "Lonis Pub" gjegjësisht Fisnik Bakija si pronar i kësaj firme, dy aktakuza penale për uzurpim dhe pengim personave zyrtar të ngritura nga Prokuroria e Shtetit që për njërën është liruar, e tjetrën është dënuar. Mirëpo me ankesë në shkallë të dytë nga i akuzuari, Gjykata e Apelit ka kthyer lëndet në rigjykim në shkallën e parë, dhe ato i ka bashkuar si një e vetme. Në vitin 2019 gjykata e shkallës parë e ka liruar nga aktakuza Fisnik Bakin. Pastaj nga Prokuroria e Shtetit dhe

KRM "Çabрати" Sh.A., është ushtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit dhe presim si do të përfundoj ky kontest. Kurse kemi edhe një kontest civil për pretendim të pronës të kompanisë sonë, padi e ushtruar Fisnik Bakia. Këtë kontest civil ne si kompani përmes avokatit e kemi fituar rastin në shkallë të parë. Pala paditëse ka ushtruar ankesë në shkallë të dytë, por që Gjykata e Apelit e ka vërtetuar Aktgjykimin e shkallës parë. Rasti është ende i hapur në proces gjyqësor dhe me datë 18.03.2022 e kemi dorëzuar parashtrësën e fundit në gjykatë.

Lënda C.nr. 1251/19 paditës Fisnik Bakija, vlera e kontestit sipas padisë 255,000.00 Euro.

2. Rasti i dytë është rasti Civ. 434/12 ku paditës është një ish punëtor Afrim Shala dhe kërkon rreth 60 mijë Euro, si kompensim dëmi pasi i ka vdekur një fëmijë në Stacionin Transfer. Rasti vazhdon në Gjykatë. Rasti është i ndjeshëm i komplikuar dhe i trashëguar nga viti 2009. Ky rast është fituar nga Kompania në Gjykatën Themelore në Gjakovë me 2016, pala paditëse ka bërë ankesë në Apel. Gjykata e Apelit me dt. 01.11.2021 ka marrë Aktvendim me të cilin e Prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë të datës 10.11.2016, dhe lënda është kthyer në ri-procedurë. Seanca për shqyrtimin gjyqësor është caktuar të mbahet me datë 14.02.2023 pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Lënda C.nr. 434/12 paditës Afrim Shala etj.. vlera e kontestit sipas padisë 56,000 euro, duke përfshirë edhe shpenzimet procedurale (pagesat e avokatit) mund të arrijë rreth 60 mijë.

3. Rasti i tretë është rasti nga vitit 2016 C. Nr. 199/16, Kompania ka ngritur padi për shqyrtim të rastit që përmes padisë civile kërkon nga Gjykata zgjidhjen e kontestit për objektin e Operativës, nëse eventualisht e humbim rastin, pasojat mund të jenë të larta nga aspekti material. Arsyeja është se AKP mund të pretendojë pagimin e qirasë për vitet e kaluara. Rasti ende është i pa përfunduar.

4. Rasti i katërt është rasti C. Nr. 137/2011 – Kontest juridik i trashëguar nga 2011 me AKP-në, e cila pretendon se është pronare e pronës "Fusha e tyrbes". Për këtë çështje duhet të ndërmerren disa veprime administrative nga ana e Komunës për ta sqaruar situatën, kjo procedurë duhet të kryhet përmes Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastër apo edhe punëve inspektuese.

5. Rasti i pestë është C.nr. 280/2015 – Kontest Pune Agron Doli. Ky rast është fituar në shkallën e parë nga pala paditëse. Kompania ka bërë ankesë në Gjykatë të Apelit. Në janar të vitit 2021 Gjykata e Apelit nxjerrë Aktvendim me të cilin e prishë Aktvendimin e shkallës së parë dhe rastin e kthen në rigjykim. Tani çështja është ende në proces në gjykatën e shkallës së parë.

6. Rasti i gjashtë është C. Nr. 553/ 17 – Kontest pune Nora Gola – Ky rast është fituar në shkallë të parë nga paditësja Nora Gola. Kompania ka parashtruar ankesë në Apel në vitin 2018. Gjykata e Apelit me datë 27.10.2021 me Aktvendim e Prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë të datës 04.02.2019 dhe lënda kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Ende në proces.

7. Rasti i shtatë është Civil –Përmbarrimor me ZRRUM – Rast i trashëguar që nga viti 2012, rasti ka shkuar nëpër disa Gjykata dhe përfundimisht është kthyer në Gjykatën Themelore në Gjakovë me Propozim për Përmbarrim shumë 31,000.00 €. Por ka ankesë për parashkrim të gjysmës së borxhit, dhe fakte se edhe mund të evitohet borxhi pasi paditësja si autoritet nuk ka vepruar sipas obligimeve të veta ligjore, ka lejuar operator privat të operojnë në zona tona të shërbimit, gjë që neve na kanë shkaktuar humbje financiare dhe pamundësi të pagesave të këtij borxhi. Lënda është ende në proces dhe nuk është caktuar se cila gjykatë ka kompetente për shqyrtimin e saj.

8. Rasti i tetë C. Nr. 287/19 është një Padi nga Agim Buza. Objekt i padisë është për anulimin e vendimit për shpëputje të marrëdhënies së punës nga KRM “Çabrat” Sh.A. Në këtë rast të punësuarit i është ndërprerë marrëdhënia e punës pas skadimit të afatit të kontratës në përputhje me Ligjin e Punës, këtë e ka vërtetuar edhe Inspektorati i Punës përmes vendimit. Por pala ka ushtruar padi edhe në Gjykatën Themelore Gjakovë për të provuar të drejtat e tij dhe kthimin në venin e punës. Rasti është pushuar me kërkesën e paditësit, por mund të aktivizohet kurdo që kërkohet nga paditësi apo e paditura.

9. Rasti i nëntë C. nr. 436/20, Paditësi Hashim Rraci, cili ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore Gjakovë duke kërkuar që KRM “Çabrat” Sh.A., ti paguaj borxhin në emër të 3 pagave jubilarë për 35 vite të përvojës së punës në shumën prej 1684.32 euro dhe në emër të një page mujore pas pensionimit në shumën prej 561.44

euro, në shumën e përgjithshme prej 2245.76 euro, me kamatë për vonesë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data 22.06.2018 si datë e pensionimit të paditësit, si dhe shpenzimet procedurale.

10. Kompania ka bërë përgjigje në padi në lidhje me këtë rast. Me datë 09.11.2021 Gjykata Themelore në Gjakovë nxjerrë Aktgjykim me të cilin Aprovohet kërkesëpadia e paditësit.

Kundër këtij Aktgjykimi kemi bërë Ankesë në Gjykatën e Apelit. Ende i pa përfunduar. 10. Rasti i dhjetë C. Nr. 437/20, Paditësi Xhafer Shyti. Paditësi ka ushtruar padi pranë kësaj Gjykate Themelore në Gjakovë. Paditësi ka kërkuar që KRM "Çabрати" Sh.A., ti paguaj borxhin në emër të 1 page jubilarë dhe në emër të një page mujore pas pensionimit në shumën e përgjithshme prej 721.46 euro, me kamatë për vonesë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data e pensionimit të paditësit. Me datë 21.12.2021 Gjykata Themelore në Gjakovë nxjerrë Aktgjykim me të cilin Aprovohet kërkesëpadia e paditësit.

Kundër këtij Aktgjykimi kemi bërë Ankesë në Gjykatën e Apelit. Ende i pa përfunduar.

11. Rasti i njëmbëdhjetë C.nr. 68/20. Paditës Bordi i Drejtorëve – kontest pune. Kompania Regjionale e Mbeturinave "Çabрати" Sh.A., me datën 01.10.2020, ka pranuar Aktvendimin për lëndën C.nr.68/20, për kontest pune parashtruar nga paditësit: Gazmend Tuzi, Nesrete Juniku, Sadri Lulaj dhe Besart Gashi, të cilët i përfaqëson av. Teki Bokshi, nga Gjakova. Brenda afatit ligjor kemi bërë përgjigje në padi. Paditësit përmes padisë së parashtruar me datë 21.01.2020 kanë kërkuar nulimin e vendimit për shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të KRM "Çabрати" Sh.A. me nr.1732 të datës 14.11.2019 dhe vërtetimin e cilësisë së të punësuarve sipas marrëveshjes së datës 20.06.2018. Rasti është ende në proces në gjykatën e shkallës së parë.

12. Rasti i dymbëdhjetë Padi në Gjykatën Komerciale e ngritur nga KRM "Çabрати" Sh.A. kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/MMPHI Prishtinë – Departamenti për Inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor. Për Anulimin e Vendimit me numër prot. 3711-4/22, të datës 11.10.2022, për hudhjen poshtë të Ankesës; dhe Anulimin e Aktvendimit të Inspektoratit të MMPHI, me numër 3711-2/22, të datës 28.07.2022, për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë në vlerë prej 10.000 (dhjetëmijë euro). Rasti ende pa përfunduar.

13. Rasti i trembëdhjetë C.nr. 1946/21 Paditësi Kurtish Morina. Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktgjykimit të datës 02.11.2022, ka refuzuar si të pabazuar në ligj kërkesëpadinë e paditësit Kurtish Morina, me të cilën ka kërkuar që të "nullohet vendimi i KRM "Çabрати" me numër 125/2021 i datës 26.10.2021 dhe vendimi i KRM "Çabрати" me numër 138/2021 i datës 05.11.2021, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe të detyrohet e paditura KRM "Çabрати" që paditësin Kurtish Morina nga Gjakova ta kthejë në marrëdhënie pune në vendin e punës, me të gjitha të drejtat përkatëse që i kishte.

Kundër këtij aktgjykimi Paditësi ka ushtruar ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë.

KRM "Çabрати" Sh.A. këtu e paditura ka parashtruar përgjigjen në ankesë duke kërkuar që Gjykata e Apelit ta Refuzojë ankesën e paditësit si të pabazë dhe t'a vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë. Rasti ende i pa përfunduar.

Kontestet Gjyqesore – vlera e kontestit sipas padive

1. Lënda C.nr. 1251/19 paditës Fisnik Bakija, vlera e kontestit sipas padisë 255,000.00 Euro.
2. Lënda C.nr. 434/12 paditës Afrim Shala etj.. vlera e kontestit sipas padisë 56,000 euro, duke përfshirë edhe shpenzimet procedurale (pagesat e avokatit) mund të arrijë rreth 60 mijë.
3. Lënda C.nr. 103/21 paditësi Agron Doli, kontest pune, vlera e padisë 25, 339.20 Euro. Ndërsa sipas Aktgjykimit të datës 15.02.2023 padisë i është aprovuar kërkesepadja për shumën prej 2,872,80 Euro plus shpenzimet procedurale në Shumen prej 1,502.00 Euro.
4. Lënda 553/2017 padites Nora Gola, kontest pune, vlera e padisë 10,393.07. Me datë 07.04.2023 Gjykata Themelore Gjakove merr Aktvendim me të cilin konsideron se padia është tërhequr.
5. Lënda Cp. nr. 1940/2016, paditës/kreditor Zyra rregullatore për Ujesjelles dhe Mbeturina (ZRRUM), vlera e kërkuar 31,000.00 €.
6. Lënda C. nr. 436/20, paditësi Hashim Rraci, vlera e kërkuar në emër të 3 pagave jubilarë për 35 vite të përvojës së punës në shumën prej 1,684.32 euro dhe në emër të një page mujore pas pensionimit në shumën prej 561.44 euro, në shumën e përgjithshme prej 2,245.76 euro.
7. Lënda C. Nr. 437/20, Paditësi Xhafer Shyti., vlera e kërkuar në emër të 1 page jubilarë dhe në emër të një page mujore pas pensionimit në shumën e përgjithshme prej 721.46 euro.

8. Aktvendimi i Inspektoratit të MMPHI, me numër 3711-2/22, të datës 28.07.2022, për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë në vlerë prej 10.000 (dhjetëmijë euro).

9. Lënda C.nr. 68/20, paditës Gazmend Tuzi, Sadri Lulaj, Besart Gashi, Nesrete Juniku (Bordi i Drejtoreve), kontest pune, kërkesë anulimin e vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës e lidhur me datë 20.06.2018 dhe e ndërprerë me 19.02.2020 (kontrata me afat 3 vjeçar) vlera e pa përcaktuar, sepse nuk është bërë ekspertiza financiare.

Kontestet Gjyqësore të prezentuara në tabelë:

Nr.	Lenda:	Vlera /Euro
1	C.nr.1251/19	255,000.00
2	C.nr.434/12	56,000.00
3	C.nr.1940/2016	31,000.00
4	C.nr.436/20	2,245.76
5	C.nr.437/20	721.46
6	Nr.3711/22	826.00
7	C.nr.68/20	16,800.00
TOTALI :		362,593.22

III. Zyra e Financave dhe Thesarit

Rrjedhjen e parasë KESH për vitin 2022;

Shpenzimet e derivative (benzin, naft dhe vajra) për muajin janar – Dhjetor 2022

Shpenzimet e riparimit të kamionave për muaj 2021 dhe 2022

Lista e pagave për muajin Korrik dhe Nëntor 2022;

Pagesat në Kesh nga Arka për vitin 2022;

Lista e shpenzimeve dhe të hyrave vjetore;

Shpenzimet e përfaqësimit dhe reprezentacionit janar – dhjetor 2022

